

SHENDETESI / SHENDETESI LAJME

Spitali Amerikan përfundon me sukses një operim të rrallë në zemër (Foto)

19.10.2016 • 14:55



Një rast i rrallë sa i përket anomalisë në zemër është shënuar në Kosovë dhe është trajtuar me shumë kujdes në Spitali Amerikan.



Kardiokirurgjia si një nga departamentet më të suksesshme të këtij spitali, ka shënuar edhe suksesin e radhës në Kosovë.



Be the first of your friends to like this

Pacientja 28 vjeçare Ardita Aliaj nga Suhareka kishte një patologji të lindur nga ato më uniket, ajo kishte Atrium unik (të vetëm) të zemrës, ku si pasojë e kësaj zemra e saj kishte tri dhoma dhe jo katër sa është normalja, dy Ventrikuj dhe një Atrium.

Pacientja ka lindur me një anomali të tillë, duke pasur vështirësi të shumta në mënyrën e të jetuarit.

Ekipi i mjekëve që realizuan me sukses operimin kardiokirurgjikë, janë Dr. Besnik Kojcici, kirurg Kardio – Vaskular dhe Dr. Fatos Kojqiqi – kirurg Kardio-Torakal.

Ky operacion për nga natyra është shumë i veçantë dhe nëse shikohet edhe në aspektin botërorë, përqindja e pacientëve me një anomali të tillë është shumë e ulët, fakt ky që e bën edhe më specifik procedurën e operimit.

Dr. Besnik Kojcici tha se pacientes në fjalë i është bërë ndarja e Atriumit në dy dhoma me një Patsch.

“Procedura e operacionit ka shkuar shumë mirë, tashmë pacientja është shumë mirë dhe gjendja e saj ka qenë shumë stabile, ajo tashmë ka katër dhoma të zemrës, dy Ventrikuj dhe dy Atriume”, thotë Dr. Besnik Kojcici – Shef i Departamentit të Kardiokirurgjisë në Spitalin Amerikan.

Dr. Fatos Kojqiqi – kirurg Kardio-Torakal tregon se pacientët të cilët mund të kenë një anomali të tillë ndihen të lodhur dhe të pa fuqishëm për të kryer punë fizike, mirëpo sipas tij personat e tillë janë shumë të rrallë.

“Një rast i tillë është shumë i rrallë, mirëpo ne jemi shumë të lumtur që gjithçka ka shkuar shumë mirë dhe se pacientja tashmë mund të vazhdojë jetën normalisht si të gjithë njerëzit e tjerë”, thotë Dr. Fatos Kojqiqi – kirurg Kardio-Torakal në Spitalin Amerikan. Sipas Dr.Fatosit rastet e tilla në botë pothuajse janë në një përqindje shumë të ulët, afërsisht 0.002%.

Kurse pacientja Ardita Aliaj, ndihet shumë e kënaqur me gjithçka

Shëndetësi

Telegrafi

Më të lexuarat në Shëndetësi

- 1 Të lodhur në mëngjes, tharje goje, etje, dëshirë për gjëra të kripura; Të gjitha këto shenja të çojnë te...



- 2 Terapia e mrekullueshme japoneze me ujë: E djegë dhjamin, e rregullon tretjen dhe i largon...



- 3 Pomada e përgatitur në shtëpi që shëron plagët, djegiet dhe prerjet sipërfaqësore; Përse duhet ta...



- 4 Psikologët brutalisht të sinqertë: Nëse ju lëndojnë fjalët dhe veprimet e dikujt – fajin e keni ju!




qe kane bere mjeket e spiraur Amerikan per te. Ajo tregon se para operimit ndihej shumë e lodhur dhe e pa fuqishme për punë fizike.

“Para se të operohesha ndihesha shumë e lodhur, gjymtyrët e poshtme më rrinin gjithmonë të ftohta, edhe gjatë verës, gishtërinjtë me mpiheshin. Ndërsa tani katër ditë pas operimit po e ndjejë menjëherë ndryshimin në gjithë trupin tim për të mirë”, thotë 28 vjeçarja, Ardita Aliaj.

Ardita shumë shpejtë pritet që t'i bashkohet familjes dhe për të vazhduar jetën normalisht si gjithë të tjerët.





Spitali Amerikan



Për jetë të qetë dhe të rehatshme – bleni banesë aty ku lindë jetë e re për ju

Sponsorizuar

[Lexo më shumë](#)

TË NGJAJSHME

Për herë të parë në Kosovë, pacientja operohet njëkohësisht në zemër dhe zorrë (Video)

I vetmuari i madh, Frederik Rreshpja

[SHFAQ KOMENTET](#)

SHENDETESI / MJEKËSI ALTERNATIVE

Terapia e mrekullueshme japoneze me ujë: E djegë dhjamin, e rregullon tretjen dhe i largon dhimbjet e nyjeve (DECETA)

